



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Tiranë, më 20.09.2024

### NJOFTIM

#### **PËR SHPREHJE INTERESI PËR TRAJTIM ME KREDI PËR QËLLIME BANIMI, INTERESAT E SË CILËS FINANCOHEN NGA SHTETI**

Bazuar në nenin 17, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe VKM nr. 22, dt. 15.01.2020, “Për miratimin e procedurës së detajuar, të kriterëve dhe të kushteve që magjistrati duhet të përmbushë për përfitimin e kredisë për qëllime banimi, interesat e së cilës financohen nga shteti”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë fton të gjithë magjistratët prokurorë që të aplikojnë për të përfituar kredi për shtëpi, interesat e së cilës financohen nga shteti.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bën thirrje që të aplikojnë të gjithë magjistratët prokurorë që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të ketë ushtruar jo më pak se tre vjet detyrën e tij;
- b) të mos ketë përfituar më parë kredi për shtëpi të financuar nga shteti, gjatë ushtrimit të funksionit të tij;
- c) të mos jetë përfituar kredia për shtëpi e subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së magjistratit, i cili ka të drejtën e përfitimit të kësaj kredie;
- d) magjistrati ose bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmija i tij nën moshën 18 vjeç nuk ka në pronësi të tij pasuri të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri të paluajtshme, që përdoret për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;
- e) magjistrati ose bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmija i tij nën moshën 18 vjeç nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë në shumën e vlerës përkatëse të kredisë të financuar nga shteti, që duhet të përfitojë magjistrati, në zonën e qendrës së qytetit ku magjistrati ushtron detyrën sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Me pasuri të mjaftueshme kuptohet çdo pasuri e luajtshme ose e paluajtshme, përfshirë mjetet motorike për qarkullim në tokë/det/ajër, likuiditete (mjetet monetare në gjendje cash, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe çdo lloj titulli tjetër pronësie të barasvlershëm me to, tituj pronësie përfshirë edhe të drejta reale pasurore, me vlerë të barabartë ose më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim.

Prokurorët që plotësojnë kriteret e mësipërme ftohen të paraqesin kërkesën për të përfituar kredi hipotekore **brenda datës 30.10.2024, ora 16.00.**

Magjistratët aplikantë dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kërkesë me shkrim drejtuar Këshillit të Lartë të Prokurorisë;
2. Autorizimin për verifikimin e pasurisë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë (sipas modelit bashkëngjitur Njoftimit në dy kopje); [Link](#)
3. Deklaratën për rrethanat, që mbështesin nevojën për strehim duke konfirmuar vërtetësinë e saj dhe pranimin e kushtit për konvertimin e drejtpërdrejtë të kredisë lehtësuese në kredi tregtare, kur vërtetohen pavërtetësi në deklaram dhe/ose rrethana të rreme (në dy kopje);
4. Certifikatë familjare dhe personale të magjistratit dhe anëtarëve të familjes në çastin e dorëzimit të kërkesës;
5. Vërtetimet individuale lidhur me pagën/të ardhurat neto të magjistratit dhe anëtarëve të familjes mbi moshën 18 vjeç të lëshuara nga punëdhënësi;
6. Deklaratat e interesave private për vitet 2022 dhe 2023 të dërguara/dorëzuara pranë ILDKPKI (fotokopje);
7. Shkresë nga Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor nëse, në emër të magjistratit dhe anëtarëve të familjes mbi 18 vjeç ka të regjistruara në pronësi automjete dhe nëse ka, vlera e tyre financiare sipas kontratës/ave të shitblerjes;
8. Shkresë nga Drejtoria e Përgjithshme Detare nëse, në emër të magjistratit dhe anëtarëve të familjes ka të regjistruara në pronësi mjete lundruese si dhe vlera e tyre (në lekë, etj) sipas kontratës/ave të shitblerjes;
9. Vërtetim nga Qendra e Regjistrimit të Aksioneve (QRA) nëse, magjistrati dhe anëtarët e familjes kanë përfituar aksione nga privatizimi i shoqërive aksionere ose nga shitblerja e aksioneve në shoqëritë aksionere të regjistruara në QRA;
10. Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) nëse, magjistrati ose anëtarët e familjes janë të pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizikë apo zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrimit tregtar;
11. Vërtetim nga Agjencia Kombëtare e Kadastrës nëse, në emër të magjistratit dhe të çdo anëtari të familjes disponohet në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë (nëse po, vlera financiare e kësaj prone sipas kontratës së shitblerjes apo vlerësimit nga eksperti i licencuar);
12. Vërtetime në 12 (dymbëdhjetë) institucione bankare nëse, magjistratët dhe familjarët e tyre (bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmija i tij nën moshën 18 vjeç) disponojnë llogari, depozita bankare (si dhe shumën nëse ka të tilla) dhe nëse, nga ana e ndonjërit prej tyre është vepruar si agjentë/kujdestarë për blerjen, ruajtjen e bonove të thesarit, si më poshtë:
  - Banka e Shqipërisë
  - Raiffeisen Bank
  - Banka Kombëtare Tregtare

- Banka Intesa San Paolo
- Banka Tirana
- Banka e Bashkuar e Shqipërisë
- Banka ProCredit Albania
- Banka e Parë e Investimeve
- Banka Amerikane e Investimeve
- Credins Bank
- Banka Union
- Banka OTP Albania

Të gjitha dokumentet e mësipërme sigurohen nga ana e magistratëve aplikantë dhe duhet të jenë origjinale (me përjashtim të Deklaratave të interesave private për vitet 2022 dhe 2023). Plotësimi i kriterëve ligjore do t'i nënshtrohet verifikimit nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Aplikimet do të dorëzohen në kopje fizike drejtëpërdrejtë ose përmes shërbimit postar **brenda datës 30.10.2024, ora 16.00**, në adresën: **Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina “Poli i Drejtësisë”, Tiranë.**